



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Sqarim rreth letër konfirmimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Fushë Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Fushë Kosovës (FK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Fushë Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Nga kategori ekonomike jo adekuate janë realizuar pagesa në vlerë 899,352€;

A1 Prezantim jo i drejtë i buxhetit final të Rezervave në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit në PVF, në vlerë 80,000€, dhe shpalesje jo e drejtë e detyrimeve kontigjente.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Fushë Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A2 Në pesë (5) kontrata ishin bërë pagesa për furnizime dhe punë ende të papërfunduara;
- A3 Në gjashtë (6) raste të projekteve kapitale nuk është bërë vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit për kohëzgjatjen e kontratës, dhe në dy (2) raste nuk është ofruar garancioni bankar për kualitetin e punimeve;
- A4 Në dy (2) raste të projekteve kapitale ishin nënshkruar kontrata me vlera më të mëdha se buxheti i paraparë;
- B2 Në një (1) rast të procedurës së prokurimit publik, fituesi i tenderit nuk kishte përmbushur njërin nga kriteret e përcaktuar me dosje të tenderit;
- B3 Në shtatë (7) raste në vlerë totale 34,900€, subvencionimi i OJQ-ve nuk ishte bërë në pajtim me Rregulloren dhe Thirrjet Publike;
- B4 Shtatë (7) fatura në vlerë totale 46,704€, pagesat janë vonuar përtej afatit ligjor prej 30 ditësh;
- B5 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e së paku 20% të pronave të paluajtshme;
- A5 Mos monitorimi i projekteve të subvencionuara, dhe mos raportimi financiar dhe narrativ nga tre (3) OJQ përfituese.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Fushë Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Fushë Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Fushë Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Fushë Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të

auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Fushë Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Kontrollet e brendshme sa i përket raportimit financiar duhet të përmirësohen dhe zbatohen tek klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë përkatëse dhe prezantimi i informative në pasqyrat vjetore financiare. Ndërsa, sa i përket çështjeve të pajtueshmërisë, duhet të përmirësohet menaxhimi dhe implementimi i projekteve kapitale, aprovimi i punimeve dhe çertifikimi i pagesave, menaxhimi i tatimit në pronë dhe inspektimit të pronave, dhënien me qira të pronave publike, proceset e subvencionimit dhe monitorimit të projekteve. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime në funksionalizimin e NjAB-së dhe Komitetit të Auditimit. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me pesëmbëdhjetë (15) rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja, dhe shtatë (7) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikim i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Gjithashtu, me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Rezultatet e testimeve identifikuan se pagesat në vlerë totale 899,352€ nuk janë klasifikuar në kategorinë e duhur ekonomike. Keq klasifikime kanë rezultuar tek këto kategori ekonomike:

- Me rastin e ekzekutimit të pagesave nga thesari për obligimet e kontratës kolektive për paga jubilarë dhe shujta, kemi vërejtur keq klasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 649,587€. Nga kjo vlerë, thesari kishte paguar sipas vendimeve të gjykatës nga kategoria e investimeve kapitale 505,627€, nga mallrat dhe shërbimet 115,450€, dhe nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve 28,509€; si dhe
- Si rezultat i vendimit gjyqësor, nga investimet kapitale janë paguar 249,765€, për shpenzime të transportit dhe parkingut të automjeteve, shërbime të kontraktuara nga komuna, që për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Sipas shënimeve të thesarit, gjatë vitit 2024, si rezultat i vendimeve gjyqësore janë realizuar pagesa totale në vlerë totale 3,342,321€⁵, të cilat sipas shpjegimeve të dhëna në PVF kryesisht janë bërë për shpenzimet që ndërlidhen me kontratën kolektive.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe vonesave në pagesat e obligimeve financiare.

Ndikimi

Regjistrimi dhe pagesa e shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF. Shfrytëzimi i buxhetit të investimeve kapitale për pagesën e shpenzimeve që i takojnë pagave dhe mëditjeve, ka reflektim negativ duke vështirësuar apo edhe pamundësuar realizimin si duhet të projekteve kapitale.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse dhe në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar

raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A1 - Prezantim jo i drejtë i buxhetit final në pasqyrat vjetore financiare dhe mangësi në shpalosjen e detyrimeve kontigjente.

Gjetja

Sipas nenit 14 të Rregullores MF.-Nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga OB-të, në raportin e ekzekutimit të buxhetit, prezantohen informatat mbi buxhetin fillestar sipas ligjit vjetor të buxhetit, dhe buxhetin final sipas SIMFK-së, realizimin e buxhetit dhe krahasimin e buxhetit final me realizimin.

Gjithashtu, neni 6 i rregullores së njëjtë, përcakton që OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare.

Në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit, buxheti final për Rezerva në vlerë 80,000€ nuk është prezantuar tek kolona përkatëse e Rezervave, por është përfshirë tek buxheti për investime kapitale.

Gjithashtu, në regjistrin e detyrimeve kontigjente të shpalosura në PVF, është përfshirë një lëndë me vlerë të papërcaktuar, për të cilën ekziston vendimi gjyqësor që padia është tërhequr nga paditësi.

Kjo ka ndodhur për shkak të gabimeve gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, por edhe për shkak të pakujdesisë dhe mungesës së personelit të mjaftueshëm në administrimin e lëndëve gjyqësore.

Ndikimi

Gabimet në prezantim kanë ndikuar që buxheti i kategorisë së investimeve kapitale të mbivlerësohet, derisa ajo e Rezervave të nënvlerësohet. Derisa, përfshirja e lëndëve apo padive që janë tërhequr ndikon në prezantim jo të drejtë të detyrimeve kontigjente në PVF.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që përgatitja dhe prezantimi i buxhetit të kategorive ekonomike në PVF të jetë në pajtim me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga OB-të. Gjithashtu, të sigurohet që lista e detyrimeve kontigjente azhurnohet me kohë, dhe se prezantimi i tyre në pasqyrat financiare të jetë i plotë dhe i drejtë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Pagesa për punë të papërfunduara sipas kontratës dhe mangësi tjera në realizim të punimeve

Gjetja

Bazuar në nenin 70.23 të rregullores 001_2022 të prokurimit publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Gjithashtu, me specifikacionin teknik të kontratave publike është përcaktuar sasia e punëve dhe kushtet tjera që kontraktuesi duhet ti realizoj, para se të ekzekutohet pagesa.

Nga testimet dhe inspektimet fizike të punimeve për projektet kapitale, kemi vërejtur pagesa të realizuara për furnizime dhe punime që ende nuk ishin përfunduar, apo nuk ishin realizuar siç kërkohej me paramasë. Raste të tilla janë vërejtur tek këto projekte:

- Kontrata “Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Sllatinë e Vogël”, në vlerë 2,188,259€, janë paguar furnizime dhe punë të papërfunduara në tërësi në vlerë 361,775€. Kjo kishte ndodhur te: pozicioni 14.7 - furnizimi, prodhimi dhe montimi i fasadës lineare me kapakë në vlerë 21,025€, dhe pozicioni 14.8 - furnizimi prodhimi dhe montimi i fasadës së venteluar, sistemi i fasadës meteon në vlerë 340,750€.
- Kontrata “Rregullimi i parkut te pishat në Sllatinë të Vogël” në vlerë 242,839€, pozicioni staza që lidhë Bardhin e Madh me Sllatinë të Vogël, ishte planifikuar që të jetë me gjatësi L=2,750m dhe gjerësi B= 1.80+1.80+1.00 (çiklizëm, ecje, dhe zhavor të imët për vrapim), ndërsa e njëjta nuk ishte realizuar sipas skemës apo përshkrimit teknik. Ishte ndërtuar rruga apo staza, por jo e ndarë sipas përshkrimit teknik, për ecje, çiklizëm dhe zhavor të imët për vrapim. Komuna nuk kishte realizuar pagesën në vlerë 14,392€, si ndalesë për mos kryerjen si duhet të disa punimeve (parking, etj), mirëpo nuk ishin ndërmarrë veprime tjera për realizim të atyre punimeve sipas kontratës;
- Kontrata “Ndërtimi i parkut rekreativ në Sllatinë të Vogël”, me vlerë 92,305€, punë të pa përfunduara kishte te këto pozicione: Punët e dyshemesë, pozicioni 3 – furnizimi transporti dhe punimi i dyshemesë me pllaka gome 20x25cm, 400m² në vlerë 12,000€, është realizuar gjysma e hapësirës, derisa është paguar tërë vlera e punimeve për këtë pozicion; Ulëset dhe Tavolinat, pozicioni 3 - furnizimi dhe montimi i ulëseve dhe tavolinave nga betoni në vlerë 2,250€, nuk ishte realizuar; pozicioni 9 - montimi i trupave ndriçues në vlerë 7,375€, ishte kërkuar që lartësia e shtyllave të jetë 9-10m, derisa ishin vendosur shtylla me lartësi më të vogël;

gjithashtu, tek pozicioni i njëjtë ishte kërkuar që pesë (5) nga trupat ndriçues të jenë dy krahësh, por nuk ishte vendosur asnjë i këtij lloji. Pas përfundimit të auditimit, nga menaxheri i kontratës kemi pranuar disa foto dhe shpjegime se kontraktuesi ka ndërmarrë veprime për realizim të pozicioneve, dhe nga verifikimi ynë i sërishëm, kemi konstatuar se punët dhe furnizimet ishin realizuar, me përjashtim të pozicionit 9 - shtyllat me lartësi 9-10m, që kishin mbetur shtyllat e vendosura me lartësi më të vogël;

- Kontrata “Ndërtimi i katit shtesë (kati të dytë) të objektit të Komunës”, në vlerë 434,895€, një pozicion ishte vendosur ndryshe nga ai i paraparë me specifikat teknike të kontratës. Konkretisht, tek pozicioni 1 - Kaldaja, ishin kërkuar 4 copë Pompë Termike Viesmann Vitacol 200-S, me vlerë 46,000€, derisa janë instaluar pompa të llojit Viesmann Vitacol 100-S; dhe
- Kontrata “Rregullimi i sheshit në lagjen Dardania”, në vlerë 691,464€, kishte mospërputhje tek pozicioni i konstruksionit metalik për mbrojtjen e drunjëve, i cili ishte kërkuar që të punohet në dy pjesë me qëllimin që të jetë i përshtatshëm për montim dhe demontim, derisa konstruksioni i vendosur nuk është punuar me mekanizmin për montim dhe demontim. Për më tepër, në shumicën e fletëve të ditarit ndërtimor është bërë një përshkrim i përgjithësuar i punëve të bëra, por pa e specifikuar numrin e drunjëve dhe konstruksioneve metalike që janë vendosur në atë ditë, dhe në cilat lokacione, dhe si rezultat, nuk mund të konfirmohet nëse sasia e furnizimeve të përfshira në situacionet e punimeve është e saktë. Ditarët ndërtimor në shumicën e rasteve nuk janë nënshkruar/aprovuar nga menaxherët e kontratës, apo edhe raste që nuk janë nënshkruar fare.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes së dobët nga menaxherët e kontratave gjatë realizimit të projekteve kapitale.

Ndikimi

Aprovimi për pagesë i punëve të parealizuara ndikon në dëmtimin e buxhetit dhe rrezikon mos arritjen e cilësisë dhe objektivave të projektit.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara. Më tutje, punët dhe furnizimet të cilat janë paguar dhe nuk janë përfunduar, të finalizohen në pajtim me kontratën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit për kohëzgjatjen e kontratës dhe mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve

Gjetja

Sipas nenit 63 të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 29, siguria e ekzekutimit (SE) kërkohet si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e SE do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. SE do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Gjithashtu, me kushtet e veçanta të kontratës (KVK) kërkohet garancioni për kualitetin e punimeve apo furnizimeve për një afat të caktuar dhe në vlerë 10% të vlerës së kontratës.

Nga auditimi i realizimit të kontratave publike janë identifikuar mangësi në pesë (5) raste tek siguri i ekzekutimit të kontratave dhe në dy (2) raste tek garancioni bankar për kualitetin e punimeve dhe furnizimeve, si në rastet në vijim:

- Kontrata “Ndërtimi i palestrës sportive në Sllatinë të Vogël”, në vlerë 2,188,259€, siguria e ekzekutimit është bërë në vlerën 165,970€, e jo në vlerë 218,826€.
- Kontrata “Ndërtimi i shkollës fillore në rrugën Amir Elmazi”, vlerë 587,119€, siguri i ekzekutimit kishte përfunduar në shtator 2024, dhe nuk ishte vazhduar, edhe pse projekti ende nuk kishte përfunduar, pasi kishte vonesa në realizim;
- Kontrata “Rregullimi i parkut tek pishat në Sllatinë të Vogël”, në vlerë 242,839€, ishte e pa mbuluar me siguri të ekzekutimit për 190 ditë, duke qenë se projekti nuk kishte përfunduar me kohë dhe nuk ishte vazhduar afati i sigurisë së ekzekutimit;
- Kontrata “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në Fushë Kosovë dhe fshatra”, në vlerë 29,970€, nuk ishte e mbuluar me siguri të ekzekutimit për 150 ditë, duke qenë se projekti nuk kishte përfunduar me kohë dhe nuk ishte vazhduar afati i sigurisë së ekzekutimit;
- Kontrata “Ndërtimi i parkut rekreativ në Sllatinë të Vogël”, me vlerë 92,305€, nuk është ofruar garancioni i kualitetit të punimeve në afatin 1 vjeçar në vlerë 9,230€;
- Kontrata “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Sllatinë e Vogël”, në vlerë 134,146€, nuk ishte mbuluar me siguri të ekzekutimit për 220 ditë, duke qenë se projekti nuk kishte përfunduar me kohë dhe nuk ishte vazhduar afati i sigurisë së ekzekutimit. Me përfundimin e projektit, nuk ishte ofruar garancioni i kualitetit të punimeve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mbikëqyrjes së dobët në menaxhimin e projekteve kapitale nga menaxherët e kontratave, dhe mungesa e përgjegjësisë për të kërkuar nga kontraktuesit vazhdimin e sigurisë

së ekzekutimit të kontratës dhe garancionit të kualitetit të punimeve.

Ndikimi

Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit të kontratës nuk garanton mbulimin e dëmeve dhe shpenzimeve në rast të mos përmbushjes së kontratës nga ana e kontraktuesit. Gjithashtu, mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve pamundëson kompensimin e dëmeve në rastet kur punët dhe furnizimet e kontraktuara nuk janë realizuar në kualitetin e duhur.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike nuk arrijnë të përfundohen brenda periudhës së kontraktuar, siguria e ekzekutimit të kontratës vazhdohet edhe për një periudhë shtesë në të cilën parashihet finalizimi i kontratës. Pagesat përmbyllëse të kontratave të mos realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar i kualitetit të punimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Nënshkrim i kontratave me vlera më të mëdha se vlera e buxhetuar

Gjetja

Me ligjin nr. 04/L-042 për prokurimin publik (i plotësuar dhe ndryshuar me ligjet pasuese), neni 9, pika 3, përcakton që: Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla. Sipas nenit 37.1 të Ligjit nr. 03/L-221 për ndryshim dhe plotësim të ligjit Nr.0/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi: “Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”. Me ligjin mbi ndarjet buxhetore, tabela 4.2 financimi i investimeve kapitale, përcaktohen shumat buxhetore për periudhën tre vjeçare për realizimin e secilit projekt të aprovuar.

Për dy (2) projekte kapitale, vlera e kontratave të nënshkruar, tejkallonte vlerat e planifikuara me ligjin e buxhetit të vitit 2024.

- Projekti “Ndërtimi i Objektivit të QMF-së, në Fushë Kosovë”, me ligjin e buxhetit të vitit 2024 përfshirë edhe projeksionet për

vitet 2025 dhe 2026 ishin planifikuar 340,000€, derisa vlera e kontraktuar është 538,228€. Me ligjin e buxhetit të vitit 2025, janë planifikuar edhe 200,000€.

- Projekti “Instalimi – rregullimi i nxehjes në objektin e komunës”, me ligjin e buxhetit ishin planifikuar 50,000, derisa vlera e kontraktuar është 81,111€. Pjesa e pa mbuluar e shpenzimeve është paguar nga buxheti i projekteve të bashkë financimeve, impianti i ujërave të zeza, dhe projektet nga donatorët dhe ministritë e linjës.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të dobëta në planifikim dhe mos përgjegjësisë për respektimin e limiteve të ndarjeve buxhetore të projekteve të caktuara me rastin e nënshkrimit të kontratave.

Ndikimi

Hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, përveç që pamundëson realizimin e projekteve sipas planit, rritë edhe rrezikun e kostove shtesë për shkak të padive që mund të bëjnë kontraktorët në rast të mos pagesës së obligimeve për punët dhe furnizimet e realizuara.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e nënshkruara të kontratave publike për projektet kapitale nuk tejkalojnë shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Përzgjedhja e operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm në procedurën e prokurimit

Gjetja

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, autoriteti kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, kriter për kapacitetin financiar ishte që OE të dëshmojë pasqyrat financiare të shoqëruara me qarkullim financiar nga banka për vitet 2021-2022-2023 apo deklaratat e tatimeve të dorëzuara në ATK, si dhe pasqyrat e audituara kopje e noterizuar. Neni 38 i Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik përcakton që, për të lehtësuar vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për tu përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigje duhet të bëhet përmes platformës elektronike të e-prokurimit.

Në procedurën e prokurimit publik për kontratën “Ndërtimi i shkollës fillore në rrugën Fazli Grajçevci në Fushë Kosovë”, në vlerë 1,085,788€, të datës 24.10.2024, fituesi i tenderit kishte ofruar qarkullimin bankar dhe deklaratat tatimore, por jo edhe pasqyrat e audituara në kopje të noterizuar, siç kërkohej me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Pas përfundimit të auditimit, komuna ka sjellur kopje fizike raportet e auditimit të pa noterizuara, duke sqaruar se të njëjtat i ka pranuar gjatë fazës së vlerësimit të tenderëve, por jo edhe kërkesën për sqarime shtesë drejtuar OE përmes platformës e-prokurimi nga komuna, për të ofruar këto raporte.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontroleve të pamjaftueshme gjatë vlerësimit të tenderëve nga komisioni i vlerësimit.

- Ndikimi** Përzgjedhja e operatorëve ekonomik fitues të cilët nuk i plotësojnë në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit rrezikon cilësinë e realizimit të kontratës, si dhe besueshmërinë në procesin e prokurimit.
- Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i tenderëve nga komisionet e vlerësimit bëhet në pajtim me kërkesat e përcaktuara me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Ofertuesit që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara të mos shpërblehen me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Mangësi në proceset e subvencionimit të OJQ-ve dhe përfituesve individual

- Gjetja** Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 10, përcakton kriteret që OJQ-të duhet të përmbushin për të përfituar subvencione, përkatësisht, paragrafi 1.4, përcakton që përfituesi të mos ketë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete. Neni 20, pika 3.4, e rregullores së njëjtë, përcakton që Komisioni Vlerësues kërkon nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve paraprake dëshmi të dorëzimit të deklaratës vjetore tatimore ose pasqyrave financiare për vitin paraprak të dorëzuara sipas kërkesave të legjislacionit tatimor për vitin paraprak.
- Me udhëzimin e Formularit 15 të bashkëngjitur në rregullore, kërkohet që secili anëtar i komisionit vlerësues do të bëjë vlerësimin në mënyrë të pavarur të propozimeve, dhe vlerësimet e tyre do të bëhen në shkallën nga 1 deri në 5 për secilën pyetje të parashtruar në formën e vlerësimit.
- Në Thirrjet publike të datave 18.03.2024, 16.05.2024 dhe 02.07.2024,

në listën e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike: ndër të tjera kërkohet: “Konfirmimi dhe pasqyra e llogarisë së paku 1 vit” Në thirrjen publike për Serra, e datës 15.04.2024, si kriter është kërkuar që aplikuesi të ketë përvojë në kultivimin e perimeve, të posedoj burim të ujit të përshtatshëm për ujitjen e perimeve, të posedoj tokë të përshtatshme për kultivimin e perimeve dhe sipërfaqeve të mjaftueshme për vendosjen e serrës.

Gjatë auditimit të subvencioneve kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Në gjashtë (6)⁶ raste të subvencionimit të projekteve të OJQ-ve, në vlerë totale 30,900€, procesi i subvencionimit nuk është zhvilluar në pajtim të plotë me kërkesat e Rregullores, për shkak se në të gjitha këto raste mungonte dokumentacioni si: deklarata për financimin e dyfishtë; deklaratat e paanësisë e anëtarëve të komisionit vlerësues; formulari i vlerësimit të aplikacioneve nga secili anëtar i komisionit të vlerësimit; deklarata për projektet e financuara nga burimet publike; pasqyrat financiare të dorëzuara në ATK; si dhe qarkullimi bankar për së paku një vit;
- Në një (1)⁶ rast të subvencionimit për rini tek projekti "Manifestimi i ditës së çlirimit", në vlerë 4,000€, ishte nënshkruar marrëveshja për subvencionim, përkundër faktit se vërtetimi tatimor ishte me afat të skaduar;
- Në një (1) rast të subvencionimit për bujqësi, përfituesi individual i një serre bujqësore në vlerë 647€, nuk kishte ofruar dëshmitë për kriterin e tokës së përshtatshme për kultivimin e perimeve dhe dëshminë e përvojës në kultivimin e perimeve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë së komisioneve për zbatimin e kriterëve të vendosura në thirrjet publike, me rastin e subvencionimit.

Ndikimi

Mos respektimi i kriterëve të rregullores për financimin e OJQ-ve, rrezikon transparencën e procesit dhe ndikon në përzgjedhjen jo të drejtë të përfituesve. E gjithë kjo rritë rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të siguroj që subvencionimi i OJQ-ve dhe përfituesve individual, të zhvillohet në pajtim me kriteret e parapara ligjore për subvencionim si dhe kriteret e përcaktuara me thirrjen publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B4 - Mos pagesa me kohë e obligimeve dhe kosto shtesë buxhetore për shkak të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore

Gjetja Neni 39.1 i LMFPF -së përcakton që ZKF i OB-së është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara ose punët e realizuara të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Shtatë (7) fatura në vlerë totale 46,704€ kishin mbetur pa u paguar brenda afatit kohor ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave ishin nga 27 deri 200 ditë kalendarike.

Gjithashtu, sipas regjistrat të siguruar nga Komuna, gjatë vitit 2024, si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesën me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve, si dhe obligimeve nga kontrata kolektive për personelin arsimor, në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore, janë paguar kosto shtesë në vlerë 847,882€.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime financiare pa pasur fonde buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave brenda afatit kohor, kanë ndikuar që komuna të jetë subjekt i padive nga kontraktuesit, duke shkaktuar kosto shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore dhe përmbarimore. Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve respektivisht implementimin e projekteve.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e obligimeve dhe menaxhimin e tyre, duke siguruar fonde të mjaftueshme si dhe pagesën me kohë të faturave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë financiare për shkak të procedurave gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Nivel i ultë i inspektimit të pronave të paluajtshme

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, kërkohet që Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Komuna nuk e ka arritë të bëjë inspektimin apo verifikimin e së paku 20% të pronave të regjistruara brenda territorit të Komunës. Komuna gjatë vitit 2024 ka bërë inspektimin e vetëm të 3.8% të pronave të përgjithshme.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe mos veprimit të mjaftueshëm në verifikimin e pronave.

Ndikimi

Mos inspektimi i pronave rezulton me informata jo të plota të pronave aktuale dhe me ndikim në vlerësim jo të drejtë dhe të saktë të ngarkesave për tatimin në pronë, respektivisht pranime më të ulëta të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Mos monitorimi i projekteve të subvencionuara dhe mos raportimi financiar nga përfituesit

Gjetja

Rregullorja MF-Nr-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 7, paragrafi 4, përcakton që, ofruesi i mbështetjes financiare duhet të emërojë zyrtarin përgjegjës apo themelojë ekip të veçantë për secilën kontratë të lidhur me OJQ-të përfituese, me qëllim të monitorimit të zbatimit të projektit/programit si dhe vlerësimit të përmbushjes së objektivave dhe arritjes së rezultateve të parapara.

Gjithashtu neni 23, paragrafi 2, përcakton që përfituesi raporton te zyrtari/ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës së përcaktuar të nenit 22 të kësaj Rregulloreje. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare dhe periudhat raportuese do të përcaktohen me dispozitat e kontratës me përfituesin.

Në tre (3) projekte të subvencionuara në vlerë totale 15,900€, përfituesit nuk kishin dorëzuar raporte narrative dhe financiare për mjetet e shfrytëzuara dhe as nuk ishin caktuar monitorues të projekteve për të siguruar se projektet janë realizuar sipas qëllimit të dedikuar. Rastet janë hasur te këto projekte:

- Turniri tradicional Bardhi i Madh, me vlerë 7,900€;
- Mbështetje financiare për Euro 2024 në Fushë Kosovë, me

vlerë 5,000€; dhe

- OJQ Sport Fit dhe fëmijë te shëndetshëm, me vlerë 3000€.

Derisa, për projektin Mbështetje financiare për mobilizimin e rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive, në vlerë 3,000€, raporti financiar nuk ishte i plotë, pasi mungojnë transaksionet bankare për kontratat e punonjësve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme për të siguruar që projektet e subvencionuara po realizohen sipas qëllimeve të përcaktuara.

Ndikimi

Mangësitë në monitorimin e projekteve dhe në raportimin e përfituesve për subvencionet e fituara rrisin rrezikun që mjetet për të cilën janë destinuar të mos e arrijnë qëllimin e duhur, gjithashtu pamundëson llogaridhënien lidhur me shpenzimin e parasë publike.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të siguroj që për projektet e financimit të OJQ-ve të bëhet monitorimi dhe të sigurohen raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përfituesit që nuk kanë raportuar për mjetet e shfrytëzuara të përjashtohen nga e drejta e përfitimit të subvencioneve në të ardhmen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga e mëditje ishte 9,225,108€, derisa gjatë vitit është shpenzuar pothuajse i tërë buxheti apo 9,222,405€, Numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 991, aq sa ishte edhe numri i planifikuar sipas ligjit të buxhetit.

Çështja A6 - Mos përfshirja e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore në procesin e rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik

Gjetja Neni 80, pika 4, e Ligji nr. 08/L-197 për zyrtarët publik, përcakton që procedura e konkurrimit për nëpunësit e shërbimit publik organizohet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NjMBNj) e organit emërues. Rregullorja (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes së mësimdhënësve dhe personelit tjetër arsimor, neni 8, pika 8 dhe 9, përcakton që pranimi i dokumenteve bëhet nga NjMBNj e komunës, e cila bënë verifikimin paraprak të të gjitha aplikacioneve dhe përpilon listën e kandidatëve që kualifikohen për vazhdim të procedurave të përzgjedhjes. Me nenin 21 të kësaj rregullore, përcaktohet që procesi i përzgjedhjes së personelit arsimor koordinohet dhe drejtohet nga NjMBNj e punëdhënësit në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Arsim, dhe se pjesë e komisionit të vlerësimit kërkohet të jetë edhe një anëtar i npominuar nga NjMBNj, e që është ekspert i burimeve njerëzore.

Në tri (3) raste të procedurave të testuara të rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik (arsim dhe shëndetësi), kemi vërejtur se Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (NjMBNj) që funksionon në kuadër të komunës përveç publikimit të konkursit në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNj), nuk është përfshirë në procesin e rekrutimeve. Në komisionet e pranimi të kandidatëve nuk kishte marrë pjesë ndonjë anëtar nga NjMBNj. Të gjitha aktivitetet dhe procedurat e rekrutimit, që nga aplikimi e deri te shpallja e rezultateve finale, ishin realizuar nga vet drejtoritë përkatëse, ajo e Arsimit dhe e Shëndetësisë, dhe sipas zyrtarëve përgjegjës, kjo mënyrë e rekrutimit është aplikuar në të gjitha procedurat e zhvilluara gjatë vitit.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në zbatimin e kërkesave ligjore dhe rregulloreve përkatëse.

Ndikimi Mos përfshirja e NjMBNj-së gjatë procesit të rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik mund të ndikojë që procedurat përkatëse të mos zbatohen në tërësi.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore koordinohet me drejtoritë përkatëse dhe përfshihet në procesin e rekrutimit të nëpunësve të shërbimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,640,974€, dhe gjatë vitit 2024 ishin shpenzuar 5,794,078€. Investimet kapitale përbëhen nga investimet në infrastrukturën rrugore, salla sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e kanalizimit, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Çështja A7 - Vonesa në realizim të projekteve kapitale, dhe mos vlerësimi i performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratave në e-Prokurim

Gjetja

Sipas nenit 70.23 të Rregullës nr. 001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave. Gjithashtu, sipas nenit 70.2 të Rregullores së njëjtë, “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualët për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”.

Nga testimet kemi identifikuar se nëntë (9) projekte kapitale nuk ishin realizuar sipas afatit kohor të përcaktuar me kontratë, si në vijim:

- Kontrata “Ndërtimi i shkollës fillore në rrugën Amir Elmazi”, vlerë 587,119€, duhej të përfundonte në mars 2024, derisa projekti ende nuk është përfunduar në tërësi;
- Kontrata “Rregullimi i parkut tek pishat në Sllatinë të Vogël”, në vlerë 242,839€, duhej të përfundonte në janar 2024, derisa kishte përfunduar në fund të vitit 2024;
- Kontrata “Ndërtimin-renovimin e sallave të sportit në SHFMU Selman Riza, SHFMU Vëllezërit Frashëri, dhe salla e arteve marciale”, në vlerë 157,693€, duhej të përfundonte në shkurt 2024, derisa kishte përfunduar në korrik 2024;
- Kontrata “Ndërtimi-renovimi i sallave të sportit në SHFMU në Miradi të Epërme, SHFMU në Bardh të Madhë, dhe salla në Lismir”, në vlerë 156,118€, duhej të përfundonte në janar 2024, derisa kishte përfunduar në korrik 2024;
- Kontrata “Ndërtimi i rrethojës dhe parkingut në oborrin e komunës”, në vlerë 247,000€, duhej të përfundonte në fund të vitit 2024, deri në kohën e auditimit (mars 2025) rrethoja nuk ishte përfunduar në tërësi;
- Kontrata “Ndërtimi i katit shtesë (kati të dytë) të objektit të Komunës”, në vlerë 434,895€, duhej të përfundonte në janar 2023, derisa projekti ende nuk ka përfunduar;

- Kontrata “Sinjalizimi i rrugëve të komunës së Fushë Kosovës”, në vlerë 99,814€, e nënshkruar më datë 29.12.2023, duhej të përfundonte brenda 70 ditë pune, derisa ishte përfunduar në prill 2025;
- Kontrata “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Sllatinë e Vogël”, në vlerë 134,146€, duhej të përfundonte në tetor 2023, derisa kishte përfunduar në shtator 2024; dhe
- Kontrata “Rregullimi i sheshit në lagjen Dardania”, në vlerë 691,464€, duhej të përfundonte në nëntor 2024, derisa kontrata ende nuk ka përfunduar.

Për asnjërin nga projektet e përfunduara me vonesë, komuna nuk kishte aplikuar ndëshkimet për vonesat në realizim të punimeve, pasi që vonesat ishin arsyetuar nga ana e menaxherëve të kontratave

Gjithashtu, në (12)¹⁰ kontrata publike menaxherët e kontratave projekteve nuk kanë bërë vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulën e menaxhimit të kontratës në platformën e-Prokurimi. Vlera totale e këtyre kontratave publike është 1,251,601€.

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur si rezultat i planifikimit jo të mirë, si dhe për shkak të mungesës së mjeteve për përfundimin e tyre sipas dinamikës së paraparë, përderisa mos përdorimi i modulit përkatës për menaxhimin e kontratave në e-prokurim ka ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mosarritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës. Mos vlerësimi i kontraktuesve përmes sistemit të prokurimit publik i pamundëson menaxhmentit marrjen e informatave në kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A7

Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin financiar, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve dhe sigurimit të mjaftueshëm të buxhetit në mënyrë që punët të realizohen sipas planit. Gjithashtu, të sigurohet se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të aplikojnë vlerësimin e kontraktuesve përmes platformës elektronike e-Prokurimi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2024 ishin 6,336,964€, prej të cilave, tatimit në pronë i takojnë 5,941,170€, qirasë nga objektet e banimit dhe objektet publike 203,941€, lejeve ndërtimore 163,965€, shitjes së banesave 21,902€, dhe 5,986€ nga largimi dhe deponimi i automjeteve.

Çështja A8 - Kontrata të qirasë për pronat komunale të pa nënshkruara nga shfrytëzuesit.

Gjetja

Rregullore QRK nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, neni 22, paragrafi 3, specifikon se "Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese".

Në shtatë (7) raste në vlerë totale 34,398€, kontratat e qirasë për vitin 2024 nuk ishin nënshkruar nga qiramarrësit e banesave komunale, por vetëm nga Kryetari i Komunës, edhe pse këto prona ishin shfrytëzuar gjatë këtij viti.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme për të formalizuar procesin e kontraktimit të pronave të dhëna me qira.

Ndikimi

Mos nënshkrimi i kontratave të qirasë nga shfrytëzuesit e tyre mund të shkaktoj paqartësi për kushtet kontraktuale në mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronave publike, por edhe vështirësi në inkasimin e të hyrave nga qiraja.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të siguroj që kontratat e qirasë të përgatiten dhe nënshkruhen me kohë nga palët kontraktuese me qëllim sigurimin e zbatimit të plotë të kushteve kontraktuale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme**Gjetja**

Sipas nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën prej dhjetë (10) eurove. Më tutje, neni 27 përcakton që, nëse tatimpaguesi nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, Komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendrike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Gjithashtu, sipas kontratës për shfrytëzim të përkohshëm të pronës publike, përcaktohet që “shfrytëzuesi i objektit pajtohet të paguajë shumën mujore të qirasë paraprakisht, deri në fund të javës së parë të secilit muaj vijues.” Ndërsa në marrëveshjen mbi qiranë për pronë banesore, përcaktohet që “qiramarrësi do ta paguajë shumën e përgjithshme bruto për muajin kalendarik, jo më vonë se me datën 10 të muajit.” Kontrata nr. 33, neni 3, pika 3.4 përcakton: “Pagesa ndaj Komunës do të bëhet në çdo muaj të përfunduar në raport me regjistrin e automjeteve të tërhequra, në llogari të Komunës, në intervalin jo më shumë se 15 ditë.” dhe pika 3.5: “Pas kësaj do të llogaritet kamata ditore prej 0.2% për çdo ditë të vonuar.” UA 06/2017, neni 16, pika 4: “Aplikuesi duhet të sjellë dëshminë e pagesës pas marrjes së konfirmimit, brenda 30 ditëve për kategorinë e II-të.”

Llogaritë e arkëtueshme, në krahasim me vitin 2023, kanë shënuar rritje për 23.67%, apo 1,212,921€. Rritja më lartë është te tatimi në pronë (5%), qiraja nga shfrytëzimi i objekteve të banimit (8%), dhe të hyrat nga shitja e pasurisë (3%). Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete ligjore me qëllim mbledhjen e të hyrave të pa arkëtuara.

Në 47 raste të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 459,481€, në tri (3) raste të lejeve ndërtimore në vlerë 52,246€, në dy (2) raste të shfrytëzimit të hapësirës publike në vlerë 13,488€, në një (1) rast të largimi dhe deponimi i automjeteve në vlerë 5,986€ dhe në (10) raste tek qiraja nga dhënia në shfrytëzim e pronës komunale në vlerë 44,457€, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbaruesit për mbledhjen e këtij borxhi, edhe pse ishte tejkaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe afati në shkresat për rikujtimin e borxhit.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të duhur të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave dhe mungesa e marrjes së

veprimeve të nevojshme për arkëtimin e tyre ka efekt negativ për buxhetin e komunës, duke pamundësuar financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur politika dhe procedura me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe se janë shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet ndaj komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

NjAB operon me dy anëtarë të stafit, drejtori i NJAB-së dhe një auditor. Gjatë vitit 2024 nuk kishte funksionuar kjo njësi për shkak të mosmarrëveshjeve me menaxhmentin e komunës dhe si rezultat nuk ishte kryer asnjë auditim. Për më shumë, gjatë këtij viti nuk ishte formuar as komiteti i auditimit.

Çështja B7 - Mos funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe mos formimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Ligji nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, neni 21 përcakton që, në raport me strukturat tjera organizative në SSP, njësia e auditimit të brendshëm ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim. Gjithashtu, sipas nenit neni 25 të ligjit të njëjtë, pika 3.3, përcakton që drejtori i NjAB-së është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e planit strategjik dhe planit vjetor për rishikim dhe miratim tek Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik (SSP) dhe te Komiteti i Auditimit, në ato subjekte ku është i themeluar ky Komitet. Më tutje, Rregullorja QRK Nr 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në SSP, neni 10 thekson se, Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik siguron burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe tjera për të mundësuar funksionimin e auditimit të brendshëm në mënyrë efektive dhe miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm. Po ashtu, Udhëzimi Administrativ MF-Nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në SSP, neni 4, përcakton që, çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar NjAB në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

NjAB nuk kishte kryer asnjë auditim gjatë vitit 2024. Kjo njësi nuk kishte funksionuar që nga viti 2023, kur Kryetari i Komunës kishte iniciuar procedurë disiplinore ndaj Udhëheqësit të NjAB-së. Me vendim të komisionit disiplinor, në mars të vitit 2023, i njëjti ishte pezulluar nga puna, me ndalesë 20% në pagë për pesë muaj dhe duke ju ndaluar kryerja e auditimeve për periudhën prej 10 muaj (01.04.2023-31.01.2024).

Pas ankesës së Udhëheqësit të NjAB-së në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në maj të vitit 2023, Këshilli kishte shfuqizuar këtë vendim të komisionit disiplinor, duke kërkuar rishqyrtim të kësaj çështje. Në qershor 2023, Komisioni disiplinor i komunës kishte rishqyrtuar çështjen, me ç 'rast kishte shfuqizuar pjesshëm vendimin paraprak, duke i mundësuar në vazhdim kryerjen e detyrave të auditimit të Udhëheqësit të NjAB-së.

Puna e kësaj njësie nuk kishte vazhduar as pas këtij vendimi, për

shkak se, sipas NjAB-së mungonte bashkëpunimi i Drejtorëve të Drejtorive Komunale për të ofruar qasje në dokumentacion dhe i mungonin kushtet themelore të punës. Përkundër kërkesave të vazhdueshme të kësaj njësie tek menaxhmenti për pajisje me kompjuterë të rinj e pajisje tjera të nevojshme për punë, duke qenë se pajisjet aktuale ishin të tej vjetruara dhe jofunksionale, menaxhmenti nuk ishte përgjigjur në këto kërkesa.

Më tutje, Udhëheqësi i NjAB-së e kishte njoftuar edhe Njësinë Qëndrore Harmonizuese (NjQH) për Auditim të Brendshëm në Ministrinë e Financave në lidhje me këto çështje. Pas kësaj, në nëntor të vitit 2023, Drejtori i NjQH i kishte dërguar shkresë Kryetarit për ta njoftuar se kjo është në kundërshtim me ligjin për kontrollin e brendshëm dhe duhet të ndërmerren veprime në funksionalizimin e punës së kësaj njësie, mirëpo edhe më tutje situata nuk kishte ndryshuar.

Puna e Udhëheqësit të NjAB-së nuk kishte vazhduar as përgjatë gjithë vitit 2024 për arsyet e njëjta. Gjatë gjithë kësaj periudhe, punën nuk e kishte vazhduar as anëtari tjetër i NjAB-së, çka do të thotë se e gjithë njësia e auditimit ishte jo funksionale. Vlen të përmendet se dy anëtarët e NjAB-së ishin paguar gjatë kësaj periudhe (ndalesa në pagë prej 20 % për 5 muaj ishte vetëm për Udhëheqësin e NjAB-së me rastin e pezullimit).

Gjithashtu, menaxhmenti i komunës nuk kishte marrë iniciativën për formimin e Komitetit të Auditimit, organ i cili e ndihmon dhe e mbikëqyrë punën e NjAB-së dhe kontribuon në krijimin e një sistemi funksional të kontrolleve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së një fryme konstruktive të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet NjAB-së dhe menaxhmentit, por edhe për shkak të neglizhencës së menaxhmentit për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi

Mos komunikimi dhe bashkëpunimi mes NjAB-së dhe menaxhmentit të komunës ka rezultuar me mos funksionim të kësaj njësie, duke pamundësuar parandalimin e mangësive në kontrollet e brendshme dhe maksimizimin e përfuturit të komunës nga puna e NjAB-së në krijimin e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë një frymë efektive komunikimi dhe bashkëpunimi me NjAB-në, duke ofruar kushte dhe mbështetje për punën e saj, ashtu që të arrihet dakordimi rreth planifikimit dhe kryerjes së auditimeve në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, duhet të formohet Komiteti i Auditimit, organ i cili ka rol aktiv në mbështetjen e NjAB-së dhe menaxhmentit për të siguruar sistem efikas të kontrollit të brendshëm të financave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk është konfirmuar nga Komuna)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹¹	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	16,285,499	23,880,872	20,814,005	16,628,215	10,322,043
Grante Qeveritare – Buxheti	12,570,892	13,794,816	13,655,242	12,344,937	7,810,357
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	78,319
Të bartura nga viti i kaluar	0	6,318,134	4,465,983	2,849,798	1,719,704
Të hyrat vetanake	3,714,607	3,714,607	2,649,268	1,380,788	697,432
Donacionet vendore	0	52,315	43,511	48,692	16,230
Donacionet e jashtme	0	1,000	0	4,000	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 7,595,372€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 1,233,923€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 6,318,134€, si dhe donacioneve në vlerë 53,315€.

Komuna e Fushë Kosovës ka shpenzuar 87% të buxhetit përfundimtar ose 20,814,005€, me një përmirësim prej 16% në krahasim me vitin 2023. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	16,285,499	23,880,872	20,814,005	16,628,215	10,322,043
Pagat dhe mëditjet	7,929,593	9,225,108	9,222,405	7,978,820	5,011,121
Mallrat dhe shërbimet	2,160,325	2,381,270	2,284,222	2,711,211	2,109,187
Komunalitë	350,000	350,000	349,905	258,388	358,896
Subvencionet dhe transferet	1,124,607	1,409,443	1,374,897	1,481,331	1,144,208

Investimet Kapitale	4,640,974	10,435,052	7,582,575	4,198,465	1,698,631
Rezervat	80,000	80,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti për Paga e Mëditje është rritur 1,295,514€. Rritja është ndikuar nga vendimet e qeverisë për mbulimin e mungesës buxhetore të shkaktuar nga pagesat e vendimeve gjyqësore në vlerën 1,280,337€, si dhe 15,177€ nga të hyrat e bartura të vitit të kaluar. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte pothuajse 100%.
- Buxheti i Mallrave dhe Shërbimeve është rritur nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar për 220,945€. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar 96%.
- Buxheti final për shërbimet komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit ishte pothuajse 100%.
- Buxheti për Subvencione dhe Transfere është rritur për 284,836€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave nga viti i kaluar në vlerë 232,521€, dhe 52,315€ nga granti i donatorëve të brendshëm. Realizimi i buxhetit të kësaj kategori në fund të vitit ishte rreth 98%.
- Buxheti për Investime kapitale në total është rritur për 5,794,078€. Rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në shumë 5,849,492€, zvogëlimi nga vendimi i qeverisë në vlerë 56,414, dhe nga pranimi i 1,000€ nga donacionet e jashtme. Buxheti i kësaj kategorie është realizuar rreth 73%, kjo për shkak të vonesave në realizim të projekteve kapitale. Programi i Investimeve Publike përfshin 81 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për investimet në infrastrukturën rrugore, salla sportive, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, rrjetet e kanalizimit, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2024 ishin 4,027,278€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga lejet ndërtimore, të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për ndërrim të destinimit të tokës, participimet, si dhe taksa tjera komunale. Për vitin 2024, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 3,714,607€, me një rritje në realizim për 311,514€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave, ka po ashtu rritje prej 671,964€, që kryesisht i përket të hyrave jo tatimore.

Në vitin 2024 Komuna ka përfituar 1,068,878€ të hyra nga gjrobat në trafik, dhe 74,750€ nga gjrobat e gjykatave. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	3,714,607	3,714,607	4,026,121	3,354,157	2,935,112
Të hyrat tatimore	1,396,069	1,396,069	1,516,002	1,489,471	821,865
Të hyrat jo tatimore	2,318,538	2,318,538	2,510,060	1,864,687	2,113,098
Të hyrat tjera	0	0	59		149

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të Komunës së Fushë Kosovës ka rezultuar me 20 rekomandime kryesore. Komuna nuk ka përgatitur Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve, dhe as raporte periodike lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2023.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, dhjetë (10) rekomandime janë zbatuar; shtatë (7) nuk janë zbatuar ende, si dhe tre (3) rekomandime konsiderohen të mbyllura, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe në vitin 2024 kemi raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të plota dhe të sakta për llogaritë e arkëtueshme, duke larguar pronat komunale nga tatimi për të i	Janë ndërmarrë veprime për adresim të kësaj çështje.	I zbatuar

		shmangur mbivlerësimit të llogarive arkëtueshme në të ardhmen.		
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të rrisë performancën e angazhimit tek stafi dhe përmirësoj komunikimin në mes drejtorive, që të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë, në mënyrë që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë.	Janë ndërmarrë veprimet e duhura dhe pasuritë janë evidentuar në regjistra të pasurisë.	I zbatuar
4.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj se detyrimet kontingjente prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Çështja lidhur me mangësitë në shpalosjen e detyrimeve kontingjente është përfshirë te çështja e PVF. Si rezultat rekomandimi i vitit paraprak, për këtë vit konsiderohet i mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen nga zyrtarët e prokurimit para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.	Edhe këtë vit janë hasur mangësi në vlerësimin e tenderëve.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe në vitin 2024 është reflektuar çështja e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet që para shtimit të numrit të paraleleve të sigurohet se ka në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për çdo pozitë për rekrutim dhe ka vende të lira për përfshirjen e tyre në listën e pagave.	Për shkak të rritjes së numrit të nxënësve në shkolla, dhe numrit të kufizuar të punonjësve të	Nuk është i aplikueshëm më

			përcaktuara me ligjin e buxhetit, dhe me qëllim të realizimit të obligimeve dhe zbatimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar, kuvendi komunal ka marrë vendim që të rrisë numrin e punonjësve të arsimit. Këta punonjës janë punësuar përmes procedurave të rregullta të rekrutimit.	
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurohet që shpenzimi i buxhetit të destinuar për vizita jashtë vendit të shfrytëzohet drejtë dhe për qëllimet specifike për çka edhe iniciohen procedurat.	Janë ndërmarrë veprime për adresim të kësaj çështje.	I zbatuar
9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që projektet e financimit të OJQ-ve të planifikohen në kohën e duhur në mënyrë që të respektohen kriteret e parapara ligjore për financimin e OJQ-ve, me qëllimin që fondet publike të shfrytëzohen në mënyrë efektive.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe në vitin 2024 është reflektuar çështja e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të sigurohet se për subvencionimin e kategorive të caktuara të shoqërisë apo edhe personave juridik janë duke u respektuar të gjitha kërkesat ligjore të cilat rrjedhin nga ligjet dhe rregulloret në fuqi.	Janë ndërmarrë veprime, për adresimin e kësaj çështje.	I zbatuar
11.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari të sigurohet që asnjë shpenzim i parasë publike të mos ndodhë pa përmbushur procedurat dhe rregullat në fuqi në mënyrë që paraja e shpenzuar të arrijë efektin e pritur.	Janë ndërmarrë veprime për adresimin e kësaj çështje.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprakisht të bëhet hartimi i	Janë ndërmarrë veprime, për adresim të kësaj çështje.	I zbatuar

		projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.		
13.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinin të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuar me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Janë ndërmarrë veprime për adresim të kësaj çështje.	I zbatuar
14.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj kontrollin e duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese të bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Janë ndërmarrë veprime për adresim të kësaj çështje.	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që para nënshkrimit të kontratave për projekte ndërtimore të hartohet një plan i detajuar ekzekutiv. Gjithashtu, duhet të sigurohet që çdo ndryshim në kontratë të jetë brenda kufijve të lejuar ligjor për të parandaluar tejkalimet e paautorizuara.	Janë ndërmarrë veprime.	I zbatuar
16.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se janë përmbush kërkesat ligjore në baza të rregullta vjetore, të sigurohet se raporti për kryerjen e inventarizimit të jetë i gatshëm në kohën e përshtatshme para përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore.	Janë ndërmarrë veprime për adresim të kësaj çështje.	I zbatuar
17.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe në vitin 2024 është reflektuar çështja e njëjtë..	Nuk ka filluar zbatim
18.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh me qëllim të mos ketë shpenzime shtesë.	Nuk janë ndërmarrë veprime, pasi që edhe këtë vit kemi raste të vonesave në pagesë të faturave	Nuk ka filluar zbatim
19.	Auditimi i	Kryetari duhet të sigurojë se NJAB	Nuk janë	Nuk ka filluar

	Brendshëm	vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Njëkohësisht të sigurohet se auditorëve të iu ofrohet bashkëpunimi i duhur dhe qasje në informata me qëllim të përmbushjes së planit vjetor të punës të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.	ndërmarrë veprime, pasi që edhe në vitin 2024 është reflektuar çështja e njëjtë.	zbatimi
20.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e komitetit të auditimit që të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit.	Rekomandimi për Komitet të Auditimit është përfshirë te çështja e Auditimit të Brendshëm.	Nuk është i aplikueshëm më

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit



Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit



Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Sqarim rreth letër konfirmimit

Pas përcjelljes së draft raportit të auditimit të Komunës së Fushë Kosovës për komente, e njëjta nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 15 ditëve. Ekipi i auditimit të ZKA-së ka komunikuar me personat përgjegjës në kuadër të komunës për ta njoftuar në lidhje me tejkalimin e afatit, dhe pas 3 ditëve vonesë, komuna dërgon komentet për shqyrtim pa letër konfirmim. Përkundër vonesave, ekipi i ZKA-së ka shqyrtuar komentet përkatëse dhe ka përgatitur draft raportin e auditimit me plotësime bazuar në këto komente, ku të njëjtin e përcjell përsëri në entitet, me kërkesën për dërgim të letër konfirmimit apo edhe komenteve të mundshme në draft raportin me plotësime, por Komuna nuk kthen më përgjigje.

Në mungesë të përgjigjes, ZKA ka publikuar raportin e auditimit të Komunës së Fushë Kosovës për vitin 2024, pa letër konfirmim apo komente.

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹² duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹³, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Paga e Mëditje në vlerë 1,460,225€, Mallra e shërbime në vlerë 142,789€, Shpenzime komunale në vlerë 8,891€, Subvencione në vlerë 41,980€, Investime kapitale në vlerë 1,688,437€.
- ⁶ Festivali 13 ndërkombëtar Euro Kosova Art Harilaq 2024, me vlerë 9,500€, Turniri tradicional Bardhi i madh me vlerë 7,900€, Mbështetje financiare për Euro 2024 në Fushë Kosovë, me vlerë 5,000€, OJQ Sport Fit dhe fëmijë të shëndetshëm, me vlerë 3,000€, Mbështetje financiare për Mobilizimin e rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive, me vlerë 3,000€, Klubi Martial Arts Fushë Kosova, me vlerë 2,500€.
- ⁷ OjQ Youth Call
- ⁸ Turniri tradicional Bardhi i Madh me vlerë, 7,900€, Mbështetje financiare për Euro 2024 në Fushë Kosovë me vlerë 5,000€, si dhe OJQ Sport Fit dhe fëmijë të shëndetshëm me vlerë 3,000€. Projekti - Mbështetje financiare për mobilizimin e rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive.
- ⁹ Projekti - Mbështetje financiare për mobilizimin e rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive.
- ¹⁰ Rregullimi i hapësirës publike të QMF-ja dhe Kompleksi 300 në rrugët 28 Nëntori dhe Kuvendi i Lezhës në Fushë Kosovë, në vlerë 109,462€, Asfaltimi i rrugës Enver Maloku dhe rrugës Hamdi Grajqevci në Fushë Kosovë - faza e parë, në vlerë 146,912€, Ndërtimi-renovimi i sallave të sportit në SHFMU Vëllezërit Frashëri në Miradi e Epërme, SHFMU Zenel Salihu në Bardh të Madhë, salla në Lismir, Ndërtimi-renovimi i sallave sportive, Lot II, në vlerë 156,118€, Ndërtimi-renovimi i sallave të sportit, Lot I dhe Lot II, në vlerë 157,693€, Rregullimi i parkut tek pishat në Sllatinë të Vogël, në vlerë 242,839€, Shënjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në Fushë Kosovë dhe fshatra, në vlerë 29,970€, Ndërtimi i rrugëve bujqësore me zhavorr, në vlerë 35,980€, Asfaltimi i rrugës Unaza në fshatin Lismir, në vlerë 45,198€, Vendosja e kubëzave në trotualet e territorit të Komunës së Fushë Kosovës, në vlerë 54,198€, Instalimi-Rregullimi i nxemjes në objektin e Komunës së Fushë Kosovës, në vlerë 81,811€, Ndërtimi i parkut rekreativ në Sllatinë të Vogël, në vlerë 92,305€, Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës, në vlerë 99,814€.
- ¹¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹² Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹³ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.